



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:276375

Datë: 10.06.2024

Numri i dokumentit: 05801553

K.DH.SH.II.nr.1039/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Dren Rogova anëtarë të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Shoqëria “Pan Pan” ShPK me seli në Fushë Kosovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Y.B. nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.121/22 i datës 31.01.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.06.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit Shoqëria “Pan Pan” ShPK me seli në Fushë Kosovë, e datës 12.05.2023, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.121/22 i datës 31.01.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Dhomës së Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.121/22 i datës 31.01.2023 është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “Pan Pan” ShPK me të cilën ka kërkuar që të I. Aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit “Shoqëria “Pan Pan” ShPK Prishtinë si e bazuar në ligj; II Anulohen akt njoftimi në formën e referencës nr. prot 559 datë 30.05.2018 si dhe vendimi nr. prot : 4669 datë 04.7.2018 si akte administrative të nxjerra në kundërshtim me ligjin; III. Konstatohet se S.A.M. dhe A.A.H. në cilësinë e pronarëve të aksioneve të shoqërisë, në pjesët ideale secili nga 20% të aksioneve, dhe/apo gjithsejtë 40% të aksioneve të Shoqërisë u merret (hiqet) e drejta e tyre si aksionarë të shoqërisë, ashtu që përfitues i vetëm i aksioneve të shoqërisë, R.M.M., në Librin e Aksioneve të shoqërisë paditëse si dhe tek autoriteti i të paditurës (MTI-së, respektivisht ARBK-së), sot ë regjistrohet si pronar i vetëm në pjesët ideale 1/1 dhe apo 100% të aksioneve të Shoqërisë Pan Pan ShPK Prishtinë; IV. Konstatohet se përfituesi i aksioneve R.M.M., nuk do të iu paguaj para as cilëndo formë tjetër kompensimi bartësve të deritanishëm të aksioneve, S.A.M. dhe A.A.H., nga shkak se përfituesi i aksioneve ka paguar si i vetëm kapitalin themeltar të shoqërisë, dhe se paditësi ishte pronar legal, autonom dhe ligjor-dhe i vetëm i të gjitha aseteve (pajisjeve) të Shoqërisë, para themelimit të saj. Ndërsa secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë paditësi për shkak të: shkeljes së dispozitave ligjore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të priset (anulohet) aktgjykimi i atakuar, KA.nr.121/22 datë 31.01.2023 dhe çështja ti kthehet Dhomës së Shkallës së Parë (I-rë) në rishqyrtim dhe rivendosje, apo aktgjykimi i goditur të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar në ligj, ndërsa aktgjykimi në formën e referencës nr.prot;559 datë 30.05.2018 si dhe vendimi nr.prot; 4669 të datës 04.07.2018 të anulohen si akte administrative të nxjerra në kundërshtim me ligjin, me konstatim se: S.A.M. dhe A.A.H., në cilësinë e pronarëve të aksioneve të shoqërisë-në pjesët ideale secili nga 20% të aksioneve dhe/apo gjithsejtë 40 % të aksioneve të shoqërisë, u merret (hiqet) e drejta e tyre si aksionar të Shoqërisë, dhe kështu përfituesi i vetëm i aksioneve të shoqërisë R.M.M., në librin e aksioneve të shoqërisë paditëse si dhe tek autoriteti i të paditurës (MINT), respektivisht ARBK-së do të regjistrohet si pronar i vetëm në pjesët ideale 1/1 dhe/apo 100% të aksioneve të shoqërisë Pan Pan Shpk me seli në Prishtinë, si kundër që të konstatohet se: përfituesi i aksioneve, R.M.M., nuk do të ju paguaj para as cilëndo formë tjetër kompensimi bartësve të deritanishëm të aksioneve, S.A.M. dhe A.A.H., nga shkak se përfituesi i aksioneve ka paguar si i vetëm kapitalin themeltar të shoqërisë dhe se përfituesi i aksioneve dhe aseteve R.M.M., ishte pronar

legal dhe autonom ligjor dhe i vetëm i të gjitha asetëve (pajisjeve si dhe sende të luajtshme) të Shoqërisë para themelimit të saj.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 par.1 të LKA-së, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve-ARBK, me vendimin nr.prot; 4669 të datës 04.07.2018, nën pikën I të dispozitivit të vendimit e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën me nr. të protokollit 4327 të datës 22.06.2018 e parashtruar nga pronari i Shoqërisë “Pan Pan” Shpk. Në pikën II, ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë- Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve-ARBK, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 16.08.2018, duke kontestuar ligjshmërinë e tij, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm.

Dhoma e Shkallës së Parë pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor, e duke u bazuar në provat dhe dokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar. Me arsyetim se gjykata vlerëson se në këtë rast duhet të aplikohet Ligji nr. 02/L-123 për Shoqëritë tregtare pasi që i njëjti ka qenë në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit nga shoqëria për bartjen e aksioneve në kohën kur paditësi ka aplikuar për bartjen e aksioneve. Gjykata po ashtu konstatoi se i padituri vendimin e saj e ka bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë tregtare, por gjykata vlerëson e kjo rrethanë nuk ishte me ndikim ndryshe në këtë çështje pasi që rregullimi ligjor ka qenë i ngjashëm dhe pavarësisht nga arsyetimi i vendimit në kuptim të dispozitave të Ligjit 06/L-016, rezultati nga shqyrtimi i kërkesës për ndryshim dhe i ankesës do të ishte i njëjtë. Gjykata vlerëson se i

padituri me të drejtë ka refuzuar kërkesën e paditësit për regjistrimin e ndryshimeve në regjistrimin e shoqërisë tregtare pasi që vendimi i dorëzuar nga paditësi nuk ka qenë i miratuar nga pronarët me të drejtë vote në kuptim të nenit 36 par.1 të LSHT. Gjithashtu gjykata vlerëson se në këtë kuptim të bartjes së interesave pronësore në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, pranuesi mund ta zotëroj interesin pronësor dhe të bëhet pronar i tij vetëm nëse të gjithë pronarët pajtohen me këtë zotërim. Nga provat e administruara është konstatuar se Aneks Statusi mbi ndryshimet dhe plotësimet e statusit, vendimi për bartjen e aksioneve dhe kontrata për bartjen e aksioneve janë nënshkruar vetëm nga M.R., ndërsa nuk janë nënshkruar nga dy aksionarët tjerë S.A.M. dhe A.A.H. të dy aksionar me nga 20% të aksioneve, veprime këto në kundërshtim me nenin 34, 96 dhe 99 të LSHT-së. Përfundimisht gjykata iu referua edhe nenit 107 par.1 pika d) të LSHT-së, andaj në këtë rast bartja e aksioneve ka mundur të bëhet vetëm pas votimit unanim të gjitha aksionarëve të shoqërisë në mbledhjen e kuvendit të aksionarëve, gjë që në këtë rast nuk ka ndodhur. Gjykata ka refuzuar propozimin e përfaqësuesit të paditësit për administrimin e provës Kërkesë për Ndihmë Juridike pasi që e njëjta nuk ishte me relevancë në vlerësimin e ligjshmërisë së vendimeve kontestuese si dhe ishte propozuar në seancën e shqyrtimit kryesor pasi që ishin administruar të gjitha provat tjera, ashtu që do të ishte në kundërshtim me parimin e ekonomizimit të procedurës. Prandaj gjykata vlerëson e në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga i padituri, drejtë a zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative, ku ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar. Mbi këto arsye thënie e paditësit në padi nuk i aprovoi, sepse ka vlerësuar pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga i padituri. Andaj, bazuar në nenet 13, par.1 nën par 1.12 lidhur me par.5 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë , si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Dhoma e Shkallës së Parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 41 par.3 dhe 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë iu ka referuar nenit 7 par.2 pika 10.9 të Ligjit nr. 04/L-006 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, si dhe në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet

Administrative . Po ashtu, Dhoma e Shkallës së Parë me të drejtë iu ka referuar edhe nenit 34 par.1 të Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare në të cilin është përcaktuar “Nëse ka ndryshime në të dhënat e paraqitura në statutin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, ose nëse pronarët dëshirojnë të ndryshojnë të dhënat ose ndonjërin nga dispozitat e marrëveshjes së regjistruar të shoqërisë, pronarët me të drejtë vote në këtë çështje duhet që së pari të miratojnë një vendim që e autorizon ndryshimin dhe plotësimin e statutit dhe/ose marrëveshjes në fjalë. Si dhe nenit 96 të LSHT Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në marrëveshjen e shoqërisë, cilido pronar mund të bëjë bartjen e interesit të tij pronësor, plotësisht ose pjesërisht përmes shitjes, pengut, dhurimit, trashëgimisë ose ndryshe; me kusht që, ky paragraf të mos interpretohet ose zbatohet në një mënyrë që ka për qëllim pengimin e veprimit të një ligji i cili rregullon transaksionet e letrave me vlerë. 96.2 Marrëveshja e shoqërisë mund të përcaktojë kufizime për bartjen e interesave pronësore, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në kufizimet e theksuara në nenet 97 dhe 98 të këtij ligji. 96.3 Të drejtat dhe detyrimet e pranuesit të një interesi pronësor janë objekt i neneve 99 dhe 100 të këtij ligji. Dhoma e Shkallës së Parë me të drejtë ka theksuar nenin 107 par . 1 pika d) të Ligjit për Shoqëritë Tregtare pasi që nuk ka pasur votim unanim të aksionarëve në mbledhjen e kuvendit të aksionarëve, nuk kanë votuar aksionarët andaj në këtë rast kolegji vlerëson se pa nënshkrimin e të gjithë aksionarëve nuk mund të bëhen ndryshime dhe plotësime të statusit të Shoqërisë, respektivisht nuk mund të bëhet bartja e aksioneve.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të procedurës, ky pretendim nuk qëndron, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore se tek aktgjykimi i goditur ekziston vërtetim i gabuar dhe jo i plote i gjendjes faktike nga se Dhoma e Shkallës së Parë gabimisht ka vërtetuar faktet vendimtare respektivisht faktet kyç nuk janë vërtetuar fare. Paditësi konsideron se baza juridike për artikulum aplikacioni për largimin e dy pronarëve që të dy shtetas turq, konsiderohet si e bazuar konkretisht mbështeten mbi bazën ligjore, paraparë me dispozitat relevante Ligji nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare me ndryshime 04/L-006, dispozita relevante Ligji nr. 03/L-154 për pronësinë e të drejta tjera sendore, status e marrëveshje mbi themelimin, inkorporimin e vendimin për bartjen pa procedurë të tenderimit të hapur dhe pa pagesë të aksioneve të shoqërisë

dhe kontratë për bartjen pa procedurë të tenderimit të hapur dhe pa pagesë të aksioneve të shoqërisë “Pan Pan” ShPK me seli në Prishtinë. Meqenëse aktgjykimi i ankimuar ka elemente determinuese të shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore si dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sipas ligjit konkludon e dhëna se tek aktgjykimi i goditur është bërë edhe aplikimi i gabuar i së drejtës materiale, çështje këto të cilat aktgjykimin e kundërshtuar si të tillë e bëjnë të jetë jo ligjor dhe të pa qëndrueshëm. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, sepse Dhoma e Shkallës së Parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit në padi janë të pa bazuara. Sepse edhe kolegji, njëjtë si Dhoma e Shkallës së Parë pasi ka vlerësuar provat dhe shkresat e lëndës ka vërtetuar se Aneks Statusi mbi ndryshimet dhe plotësimet e statusit, vendimi për bartjen e aksioneve dhe kontrata për bartjen e aksioneve janë nënshkruar vetëm nga M.R., ndërsa nuk janë nënshkruar nga dy aksionarët tjerë S.A.M. dhe A.A.H. të dy aksionar me nga 20% të aksioneve, veprime këto në kundërshtim me nenin 34, 96 dhe 99 të LSHT-së, pra nuk është mbajtur mbledhja e kuvendit të aksionarëve lidhur me bartjen e aksioneve ku është dashur të votojnë të gjithë aksionarët. Andaj, kolegji vlerëson se aktgjykimi i ankimuar është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, sepse Dhoma e Shkallës së Dytë nuk ka gjetur dëshmi që do të mund të vërtetonte një gjendje tjetër faktike nga gjendja faktike e konstatuar nga Dhoma e Shkallës së Parë, për arsye se paditësi nuk ka ofruar prova të bazuara që do të ndryshonin gjendjen faktike të vërtetuar nga Dhoma e Shkallës së Parë. Andaj, sipas vlerësimit të kolegjit, aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, ngase nuk është shkelur ligji material në dëm të paditësit.

Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadiisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.1039/23, me datë 10.06.2024

**Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**